

## 6.3 SHUMËFISHIMI I FUSHËS 996/997

Fushën 996/997 mund ta shumëzoni brenda regjistrimit bibliografik. Të dhënat nga fusha bazë 996/997 do të kopjohen në fushat e krijuara në atë rast.

Kërkoni fushën që dëshironi të shumëzoni. Specifikoni sa kopje të fushës dëshironi të krijoni dhe përzgjidhni nënfushat që dëshironi t'i transferoni në fushat e reja.

### **Kushti**

Në fushën 996/997, gjenden të dhënat për koleksionet e bibliotekës për njësinë, e cila nuk është e lidhur në komplet.

### **Procedura**

1. Në klasën **Fusha 996/997** ose në lidhshmëritë e klasës **Materiali**, kërkoni dhe përzgjidhni fushën 996/997.

2. Përzgjidhni metodën **Objekti / Shumëfisho fushën 996/997**.

Dritarja **Shumëfishimi i fushës 996/997** do të hapet.

Futni numrin e fushave që dëshironi t'i keni (krijoni).

Nga lista e nënfushave, të cilat mund t'i transferoni, fshini kodet që nuk dëshironi t'i kopjoni.

Shënoni kutinë për zgjedhje "Hap redaktuesin për fushat 996/997", nëse dëshironi t'i shqyrtoni dhe redaktoni të dhënat në fushat e reja.

Paralajmërim:

*Nëse dëshironi të kopjoni shenjën e kopjes, futni kodin c. Nëse në vend të numrit të vendit në tërësi (kodi D), dëshironi të kopjoni ndonjë element të veçantë të numrit të vendit, futni kodin e elementit në formën si vijon: dl, di, da, dn...*

*Gjatë kopjimit të numrit të inventarit, numrit të huazimit dhe numrit në vazhdim, do të shkarkohen emrat e numërorëve, në bazë të të cilëve përcaktohen numrat e rinj.*

*Nëse është përcaktuar parametri për përzgjedhjen automatike të numërorit për numrat në vazhdim ose numrat e inventarit, te secila fushë, në varësi nga kushtet, do të kërkohet dhe përzgjidhet rishtazi numërori sipas të cilit pastaj përcaktohet numri (shih kapitullin 13.2.1).*

*Data e inventarizimit përcaktohet gjatë "kopjimit" të numrit të inventarit. Nëse dëshironi të kopjoni datën e inventarizimit, futni kodin o.*

3. Klikoni butonin **Në rregull**.

Do të hapet lista e fushave 996/997 që është krijuar. Ato mund t'i përzgjidhni dhe kështu t'i vendosni në hapësirën e punës.